



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 41
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I
Prishtinë, më 19 tetor 2016, në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fadil Beka, Mirjetë Kalludra, Besa Baftiu, Ali Berisha dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan : Adem Hoxha dhe Fikrim Damka,

Të ftuar : Lul Raka- anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Hysni Bajrami- kryesues i Bordit për regjistrim dhe licencim të profesionistëve shëndetësor, Drita Zogaj- kryesuese e Bordit për Shkollim Specialistik.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatorë e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 28.09.2016 dhe 05.10.2016;
3. Diskutim rreth titujve profesional për punëtorët shëndetësor ;
4. Diskutim për ndarjen e specializimeve të profesionistëve shëndetësor;
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 28.09.2016 dhe 05.10.2016;

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura me 28.09.2016 dhe 05.10.2016.

3. Diskutim rreth titujve profesional për punëtorët shëndetësor ;

Kryetarja, kemi pas takime me disa mjek dhe disa profesionist tjerë si biokimist, biolog aplikativ të cilët kanë pengesa të punësohen për shkak të titullit të tyre profesional të pa definuar mirë.

Këta profesionist nuk mund ti vazhdojnë as studimet post diplomike sepse këto studime janë mbyll për këto degë. Ka edhe disa profesione tjera nuk janë të rregulluara në mjekësi.

Shukrije Bytyçi, çështja e titujve profesional është shqetësuese sepse kur po hapen drejtimet e reja të studimeve nuk po shikohet mirëfilli se ku do të punësohen ata student pas përfundimit të studimeve. Fjala është për drejtimin e shkencave matematiko natyrore, drejtimi i biologjisë aplikative, drejtimi bio-kimiko fiziologjik, baqeller, të cilët nuk kanë as të drejt pune, as të drejt të studimit të mëtejme sepse këto drejtime janë mbyllur dhe kanë bredh rrugëve me vite të tëra. Disa nga ta punojnë në laboratorë por janë të shënuar si pastrues apo punëtor teknik. Këta duhet ta kenë të drejtën të punojnë në laborator sepse kështu është në të gjitha shtete evropiane. Një shkresë që këta kanë pranuar nga Ministria e Shëndetësisë është e tmerrshme, e shkruar me dorë dhe ku u thuhet se gjatë studimeve nuk kanë pas lëndë mjekësore, gjë që nuk është e vërtetë. Laboratorët në Kosovë ende veprojnë me një udhëzim administrativ të vitit 2006.

Kryetarja, çështja e biologjisë aplikative është diskutuar edhe më herët, por është thënë se shkollimi i tyre është i pamjaftueshëm për të qenë punëtor shëndetësor por çështja është pse nuk u është mundësuar të vazhdojnë studimet postdiplomike.

Besa Baftiu, shqetësimi imë është në kuadër të specializimeve që u janë ndarë neonatologëve si drejtim i veçantë, por në fakt që janë si subspecializime e jo si specializime. Plan programi specialistik i neonatologëve është i njëjtë me pediatri por ne nuk mund të punojmë si pediatër , dhe nenonatolog nuk ka specialist as në regjion as në BE, pra ne është dashur të jemi si specialist pediater- nenonatolog.

Pyetja ime është se tani pasi nuk ka më specializime që ndahen për nenatologji atëherë çka do të bëhet me këtë grup të specialistëve që e kanë titullin nenatolog?

Drita Zogaj, sipas udhëzimit 10/2016 neni 74 e përcakton profilizimin e specializimeve dhe ne kemi vendosur të fillojm me profilizimin e specializimeve internistike , kirurgjike dhe pediatrike. Kemi filluar me profilizimin e specializimeve internistike por nuk kemi pasur asnjë kërkesë prej specializimeve pediatrie ku hyn edhe nenonatologët.

Hysni Bajrami, ka disa brenga të adresuara rreth profileve mjekësore të cilat nuk i akomodon Ligji i shëndetësisë. Kemi një mos koordinim me Ministrin e Arsimit e cila akomodon programe të cilat nuk gjejnë aplikim në shëndetësi. Ka qenë një problem i madh me biologët aplikativ i cili është zgjedhur dhe të gjithë janë licencuar. Çështja e kandidatëve të shkencave matematiko natyrore, kemi kërkuar nga Komisioni vlerësues i licencimit të bëjmë një barasvlerësim dhe të shikohet a kanë ata lëndë mjekësore të mjaftueshme për licencim si profesionistë shëndetësor, dhe është konstatuar me procesverbal se nuk kanë lëndë të mjaftueshme prandaj duhet ti nënshtrohen një moduli shtesë dhe pastaj të licencohen. Atë modul shtesë duhet ta organizoj ministria e Arsimit.

Shukrie Bytyçi, çështjet shëndetësore janë të gjithë popullatës dhe duhet të diskutohen. Biologët aplikativ , drejtimi biokimiko fiziologjik baqeller dhe që janë rreth 100, janë të pa licencuar.ne duhet të ndërmarrim diçka që tu gjindet një zgjidhje që ata të kanë të drejtë të punojnë.

Ali Berisha, politik është bërë kur është hap drejtimi për këto studime por tani duhet gjetur zgjidhje. Nuk mendoj se të gjithë profesionistët e biologjisë ose të biokimisë kanë hapësira të kycen në mjekësi. Janë procedura dhe licencime që duhet të kryhen për të qenë pjesë e shëndetësisë. Biokimistëve 5 vite u zgjat specializimi pas përfundimit të fakultetit, për të qenë biokimist në institucione shëndetësore dhe çdo lëshim i caktuar ligjor dhe licencim i të tjerëve pa kritere është gabim.

Kryetarja, kjo çështje duhet të merret më seriozisht nga institucionet dhe të gjendet një zgjidhje dhe të ju mundësohet edhe një takim me ta që ti shfaqin kërkesat e tyre.

Lul Raka, unë përkrah të drejtat e studentëve dhe shpesh janë bërë gabime në hapa dhe kanë pësuar studentët. Agjencia e akreditimit nuk merret me akreditimin e profesioneve por të institucioneve dhe programeve. Në Kosovë po ndodh një mos koordinim në mes të institucioneve e që ky mos koordinim po reflektohet në shumë fusha. Përkrahi zgjedhjen më të mirë për atë grup të studentëve sepse ata nuk kanë faj, fajtorët jemi ne që i kemi sjell në atë situatë.

Shukrije Bytyç, këta student duhet ti takoj rektori dhe të gjithë akterët tjerë të involvuar dhe ta gjejnë një zgjidhje.

Hatim Baxhaku, ne sot nuk mund të gjejmë zgjidhje , por as të ftuarit nuk mundtë gjejnë zgjidhje shpejt se problemi është multi – disiplinuar. Jo të gjithë biokimistat mund të punojnë në shëndetësi sepse nuk janë profesionist shëndetësor. Një emërtim profesional duhet të ju gjendet që ata të punojnë në ndonjë laborator jo mjekësor.

Hysni Bajrami, së fundi Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrin e Arsimit që me rastin e akreditimit të programeve shëndetësore të konsultohet ministria e Shëndetësisë. Gjithashtu kemi kërkuar nga Ministrin e Arsimit që diplomat që vinë nga jashtë me tituj të ndryshëm profesional ti barasvlersojnë.

Kryetarja, kërkojmë nga institucionet si Ministria e Arsimit dhe e Shëndetësisë që të merren me problemin e këtyre të diplomuarve, e të cilët nuk e kanë të drejtën e bartjes së një titulli profesional që do ju mundësonte e drejta e punësimit qoftë në sektorin publik apo privat si dhe tu mundësohet e drejta e përfundimit të studimeve postdiplomike në Kosovë.

4. Diskutim për ndarjen e specializimeve të profesionistëve shëndetësor;

Kryetarja, do të diskutojmë për ndarjen e specializimeve ku si komision kemi marr një shkresë por edhe i kemi taku doktorët që kanë konkurruar dhe janë të pa kënaqur me ndarjen e specializimeve. Gjithashtu gjatë monitorimit të Ligjit për Shëndetësi kemi hasur në kërkesa të spitaleve rajonale për specialist të ndryshëm e që kërkesat e tyre nuk përputhen më ndarjen e specializimeve që kanë ndodhur. Vërejtja kryesore ishte në kriteret që ju janë parashtruar mjekëve për të fituar specializim. Kishte edhe shumë mjek që me not mesatare 9 e më shumë nuk janë pranuar, ndërsa poentomi nga Komisioni ka qenë disa herë më i lart se poentomi që kanë marr nga nota mesatare e studimeve dhe nga përvoja e punës. Kemi pasur indikacione se ka pasur edhe nepotizëm, prandaj që të mos ketë

moskuptime kemi caktuar edhe këtë takim që ta sqarojmë këtë situatë të krijuar. A mund të na sqaroni se a janë në rregull këto kritere të caktuara?

Hatim Baxhaku, shqetësimet e kandidatëve për specializim duhet ti trajtojmë. Ne mund të japim vërejtje dhe rekomandime nëse mendojmë që ka lëshime, por zgjidhja mund të gjendet në dy shkallshmërinë e ankesave. Gjithashtu para hapjes së konkursit për specializime duhet të konsultohen institucionet shëndetësore për nevojat e tyre. Ne kemi pak vërejtje në kuotimin e kritereve për vlerësim dhe poentim të kandidatëve, por bordi ndoshta do të na sqaroj dhe arsyetoj këto kritere dhe këtë poentim. Mendoj se bordi në bazë të ankesave ndoshta duhet të ndryshoj diçka dhe anëtarët e bordit mendoj se nuk duhet të kenë kaq shumë poena në krahasim me notën mesatare dhe kohen e pritjes.

Besa Baftiu, mendoj se ne kemi kompetenca të caktuara në këtë çështje pasi ne e mbikëqyrim ministrinë, e ministri ka kompetenca mbi bordin që ka bërë përzgjedhjen. Kërkojmë nga kryesuesja e bordit të na sqaroj rrjedhën e procesit e pastaj do të kërkojmë llogari edhe nga ministri. Të vlerësohet nota mesatare mbi 9 me 2 poena ndërsa një anëtar i komisionit të ketë 1 deri 3 poena, nuk është në rregull. Pastaj edhe kohëzgjatja e intervistës 1 deri në 2 minuta, si keni mundur ti vlerësoni kandidatët për çështje profesionale për këtë kohë kaq të shkurtë. Si e kini vlerësuar kandidatin a e një gjuhen angleze me një ose dy pyetje pa ju kërkuar dokumentet e lëshuara nga institucionet përkatëse që e vërtetojnë njohjen e gjuhës angleze. Kërkoj të na sqaroni si bord se si ka shkuar procedura edhe pse e dimë në detale si ka shkuar përzgjedhja, dhe e dimë se ka pasur parregullsi.

Kryetarja, kur është nxjerr akti nënligjor dhe si janë caktuar kriteret.

Ali Berisha, ne gjatë vizitës në spitalet regjionale i kemi par kërkesat e tyre për specialist dhe është një bindje e përgjithshme se specializimet janë duke u ndarë për nevoja të individëve të caktuar e jo për nevoja të institucioneve. Kjo është shqetësuese sepse institucionet shumë shpejt kanë me na mbet pa profesionist të caktuar. Ku problem rrjedh nga mos planifikimi i mirë i institucioneve apo mos dëgjimi i kërkesave të tyre nga ata që bëjnë ndarjen e specializimeve. Për mua kriteret janë jashtë çdo logjike ku studimet 5 vjeçare barazohen me vlerësimin e vetëm një anëtarit të bordit. Kriteret nuk janë të rregullta dhe nuk e ndihmojnë vlerësimin e drejt. Bazuar në faktet që i kemi duhet të kërkojmë prej ministrit që të shikoj mundësin e anulimit të konkursit. Kërkoj të na njoftoni si i keni vendosur ato kritere?

Shukrije Bytyçi, pajtohem me konstatimin se gjatë monitorimit të ligjit e pamë që shumë reparte do të mbyllen sepse nuk ju janë nda specializime të lëmive përkatëse. Konkursi nuk ka qenë në përputhje me udhëzimin administrativ, pastaj ka pas nepotizëm, pyetjet kanë qenë joadekuate dhe kandidat janë vlerësuar edhe nga anëtarët e komisionit pa qenë prezent fare, vlerësimi i gjuhës angleze ju është bërë nga ata që ndoshta vet nuk e dinë gjuhen angleze dhe shumë parregullsi tjera. Kur mjekët kanë kërkuar takim për tu sqaruar me bordin, janë ftuar policia për ti larguar nga dyert e ministrisë. Po ju përmendi disa fakte ku ka pas nepotizëm, djali, reja dhe dhëndri i Gani Shabanit ish sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë, vëllai i presidentes Atifete Jahjaga, dhëndëri i profesor Nazmi Hysenit, djali i profesor Nehat Baftiut, djali i vëllait të Basri Lenjanit etje, ku 28 kandidat që e kanë fituar specializimkan kanë lidhje të ndryshme me anëtarët e komisionit dhe me profesor dhe mjek të njohur. Kërkoj anulimin e konkursit ose pranimin e të gjithë kandidatëve që vërtet e meritojnë.

Kryetarja, jam kundër nepotizmit por nuk do të thotë që edhe fëmijët e profesorit nuk mund të jen mjek të mirë.

Drita Zogaj, sipas udhëzimit administrativ 2014/10, emërohet bordi qendror për shkollim specialistik, i cili përbëhet nga 11 anëtar me përfaqësues të deleguar nga institucionet e përcaktuara me udhëzim administrativ. Planifikimi për specializime është bërë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik që i ka bërë në bazë të nevojave dhe në bazë të numrit të banorëve por duhet pas parasysh që kemi edhe specializant që janë në specializim nga konkursat e më hershme dhe do ta përfundojnë specializimin me kohë, që spitalet të mos mesin pa kuadro.

Kriteret janë përcaktuar në bazë të udhëzimit dhe është modeli i viteve të më hershme, ku më herët kanë hy në test por pasi ka pas aludime që po shpërndahet testi, i kemi pyetur me gojë. Ka pas edhe rënie të dijes dhe përgjigje shumë të dobëta. Kriteret e konkursit kanë qenë publike dhe askush nuk është ankuar. Në pyetjen se pse kanë qenë vetëm 2 pik në vlerësimin e suksesit arsye është se po na vinë student nga universitetet private, nga Shqipëria dhe nga Maqedonia me nota shumë më të larta e ne për ti dhënë prioritet universitetit publik kemi shkuar në atë vlerësim jo shumë të madh të notës. Një kandidat që u përmend me not mesatare 10, pyetjet nuk i ka dit, por edhe na ka than se unë e dua vetëm një letër me ma dhanë se unë nuk rri në Kosovë, ndërsa kundër kandidati ka pas not mesatare 9.6 dhe do të rrijë në Kosovë dhe ne e kemi përzgjedh. I kemi edhe 65 vende të lira dhe do të përsëritët konkursi, për më shumë nuk kemi kapacitete mentorale. Sidomos kemi problem për stomatologët sepse nuk po kanë kapacitet të pranojnë më shumë specializant. Kemi edhe 165 specializant në kirurgjinë orale në pritje.

Është mundësia që të bëhet një ndryshim në udhëzim administrativ që është vetëfinancimi, që nëse kandidati e gjen mentorin adekuat atëherë të ketë të drejt ta fitoj specializimin me vetëfinancim.

Sa i përket njohjes së gjuhës angleze si kriter, e kemi vendos sepse viti i fundit është obligim për çdo kandidat që do të dalë jashtë Kosovës.

Sa i përket nepotizmit mundem me ju than se shumë ma shumë ka fëmijë të mjekëve që kanë mbetur pa u pranuar sesa që janë pranuar.

Kryetarja, a do të shqyrtohen ankesat e kandidatëve nga bordi?

Drita Zogaj, ankesat janë duke u shqyrtuar dhe aty ku ka ndonjë gabim do të përmirësohen.

Kryetarja, sa i përket veteranëve dhe fëmijëve të dëshmorëve sipas informatave që kemi janë vlerësuar me 5 pikë, a është në rregull që mu vlerësuar më shumë se përgatitja shkollore dhe përvoja e punës. Ligji thotë se në kushte të barabarta duhet të ketë përparësi, edhe pse nuk ka shumë kandidat që i përkasin kësaj kategorie.

Drita Zogaj, ne e kemi bërë këtë kriter pasi më herët ata kanë pasur kuot të veçantë, tani kemi caktuar 5 pikë por vetëm për veteranët dhe për fëmijët e dëshmorëve të cilët e kanë dëshmuar me dokumentacion.

Si bord mendojmë se kandidatët që janë vullnetar ti sistemojmë por problem kemi me stomatologët se nuk po kanë mentor.

Kryetarja, kemi edhe një kërkesë që të kini kujdes që mos të shkelen të drejtat e këtyre kandidatëve, e pastaj të ndërhyjnë Avokati i Popullit apo dikush tjetër. Të shqyrtoni edhe një herë ku kanë ndodhur këto gabime, të shqyrtoni mundësin e anulimit të konkursit apo të përmirësimit të gabimeve.

Besa Baftiu, ministri në një intervistë në vitin 2015 ka thanë se nëse ndahen specializime do të ndahen vetëm sipas kërkesave dhe nevojave, dhe pasi kjo nuk është realizuar sipas këtij deklarami, ministri mendoj se do ta anuloj konkursin.

Hysni Bajrami, procesi është në procedurë të ankimimit dhe duhet ti besoni komisionit të ankesave sepse është një procedurë administrative e cila do të respektohet. Përmes ndryshimit të udhëzimit administrativ është plotësisht e mundshme që të kyçen të gjithë në proces të specializimit, sepse ka modalitete të ndryshme.

Ankesat do të shqyrtohen nga Komisioni për ankesa e jo nga Bordi për shkollim specialistik.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që të realizoj një takim me ministrin e shëndetësisë z.Imet Rrahmani, ku do të kërkohet nga ministri të angazhohet në mbikëqyrjen e procesit të ndarjes së specializimeve dhe zgjidhjen e problemit të ngritur rreth specializimeve.

5. Të ndryshme.

Kryetarja, për këtë pikë kemi pas një kërkesë nga Osman Osmani i sindikatës UNIA nga Zvicra për një takim, dhe nëse pajtohen anëtarët e komisionit do të organizojmë një takim me ministrin e Ministrisë së Punës z.Arban Abrashi dhe ta diskutojmë marrëveshjen e pensioneve me Zvicrën dhe ku mund të marrin pjesë edhe anëtarët e sindikatës UNIA. Ministri më herët na ka than se jemi në rrugë të mirë për arritjen e marrëveshjes. Ta shohim ku ka ngelur procedura.

Gjithashtu kam edhe një çështje tjetër , mendoj se duhet të kërkojmë nga ministri i shëndetësisë dhe ministri i punës që në takime për bashkëpunim ndërshtetërorë që realizojnë brenda dhe jashtë vendit të ftohet edhe një ose dy anëtarë të Komisionit tonë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:05.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA